



01 Nr. 723/24 Dt. 21.11.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas shqyrtimit të kërkesës 01-030 nr. 147826 e datës 07.11.2024, e parashtruar nga Edon Thaçi, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa 01-030 nr. 147826 e datës 07.11.2024, e parashtruar nga Edon Thaçi, organizator i turneut “Përparim Thaçi”, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e turneut tradicional “Përparim Thaçi”, në Prizren si dhe shfrytëzimin e qendrës rekreative sportive “Sezai Surroi”, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve për kupa, medalje, topa, pije dhe ushqim, lejohen mjetet financiare në shumën prej 1,000.00 € (njëmijë euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurit,
 - Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Arkivës së Kryetarit.